

Tregimet që na krijojnë: Rrëfimet evropiane të Holokaustit dhe premtimi i praktikave të kujtesës kozmopolite shqiptare¹

Kailey Rocker
Lawrence University
kailey.rocker@lawrence.edu

Abstrakti

Në këtë punim, do të gjurmoj se si rrëfimet përkujtimore të Holokaustit përdoren në kontekstin bashkëkohor shqiptar për të krijuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë të këtij vendi me atë histori. Po ashtu, do të gjurmoj debatet mbi njohjen, pikëllimin dhe përfaqësimin e atyre që humbën gjatë regjimi socialist, nga viti 1944 deri në vitin 1991. Veçanërisht, përqëndrohem në përpjekjet e historianëve dhe politikanëve vendas si dhe historiografë të huaj amatorë dhe ekspertë pas vitit 1991, të cilët paraqesin Shqipërinë si një strehë të sigurtë për komunitetin hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore si dhe përpjekjet e fundit për të përkujtuar Kampin e Internimit të Tepelenës të epokës socialiste, i cili gjatë punës sime në teren u quajt jozyrtarisht si Aushvici i Shqipërisë. Unë iu qasem këtyre rrëfimeve përmes thjerrzës së përvetësimit të kujtesës (Subotić 2019) në mënyrë që të kuptojmë se si rrëfimet shqiptare kontribuojnë në deterritorializimin dhe dekontekstualizimin e asaj që Levy dhe Sznajder (2002) e quajnë kulturë kozmopolite të kujtesës. Ndonëse të ndryshme, unë argumentoj se të dy përvetësimet flasin për kryqëzimin e shtigjeve të mëposhtme: përpjekjet shqiptare për të marrë pjesë në peizazhet më të gjera evropiane të kujtesës përmes riprodhimit të rrëfimeve të tyre specifike kombëtare dhe përpjekjeve më të gjera evropiane për të siguruar rrëfimet e kujtesës përmes përfshirjes së Evropës Juglindore.

Fjalët kyçe: *Shqipëria, Holokausti, kujtesa kozmopolite, përvetësimi i kujtesës, postsocializmi*

Hyrje

Deri sa po lëvizja nëpër listën e emailave të mi së fundmi, më tërhoqi vëmendjen njëri prej tyre i quajtur: “Ftesë për shfaqjen e filmit ‘Besa: Premtimi’”, ngjarje kjo që do të zhvillohej në qendër të Vankuverit, B.C.² Siç tregohet nga emrat e sponsorëve të kësaj ngjarje - organizata të tilla si Qendra Edukative e Holokaustit në Vancouver dhe Shoqëria Shqiptare Toka e Shqiponjave e BC-s - shfaqja premtoi se do të lidhte dy tema: shtet-kombin e vogël evropian juglindor të Shqipërisë me Holokaustin, veçanërisht

reagimin heorik të shqiptarëve që fshihnin familjet hebreje që ikën nga persekutimi nazist. Ky email u përzie me rrëfime të ngjashme të përkujtimit të Holokaustit që kishin kaluar në tryezën time në vitet e fundit. Në vitin 2018, dolën shumë artikuj lajmesh që përkujtonin diplomatin zviceran Carl Lutz, i cili shfrytëzoi punën e tij në Konsullatën Zvicerane në Budapest për të shpëtuar dhjetëra mijëra hebrenj hungarezë mes viteve 1942 dhe 1945.³ Në vitin 2019, *Sarajevo Times* botoi një histori për hebreun boshnjak Eli Tauber dhe misionin e tij për të ndarë historitë e familjeve boshnjake që kishin rrezikuar jetën e tyre për të mbrojtur hebrenjtë nga persekutimi fetar dhe etnik. Për Tauber, kjo vepër përbente një aspekt të rëndësishëm të ndërtimit të komunitetit në Bosnje dhe Hercegovinë pas shpërbërjes së Jugosllavisë, e cila u shpërbë edhe përgjatë linjave etnike, gjinore dhe fetare.⁴ Ngjashëm, regjisorja e filmit Sabina Vajraca e cila vepron në SHBA, u bazua në përvojën e saj si e ikur nga Bosnja e shkatërruar nga lufta e viteve 1990 për të realizuar filmin *Sevap/Mitzvah* (Një vepër e mirë) i cili trajton historinë e gruas muslimane boshnjake Zejneba Hardaga, e cila rrezikoi mirëqenien e familjes së saj për të mundësuar arratisjen e familjes hebreje Kabiljo nga nazistët nga Sarajeva e pushtuar.⁵ Parë në këtë kontekst, shfaqja e filmit “Besa: Premtimi” në Vankuver në 2023 ndjekë një histori të pasur lajmesh dhe mbulimi dokumentar që dolën nga Evropa Lindore gjatë viteve 2010, duke demonstruar veprime heroike që familjet dhe individët vendas ndërmorën për të zbutur tragjedinë kolosale të humbjes njerëzore, shpesh me kosto të mëdha për veten e tyre, ndërsa jetonin dhe punonin në shtete që ishin ose të pushtuara ose në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me forcat nacional-socialiste gjermane në vitet 1940.

Filmi “Besa: Premtimi”, i cili fillimisht u lansua në vitin 2012 pas publikimit të librit, ishte rezultat i bashkëpunimit mes fotografit hebre amerikan Norman Gershman dhe shqiptarit mysliman Rexhep Hoxha, familja e së cilit strehoi një familje hebreje gjatë Luftës së Dytë Botërore. Tregimi ndjek udhëtimin e tanishëm të Hoxhës për të kthyer një grup librash të lëna pas nga *mysafirët* (të ftuarit) e familjes së tij. Përderisa Gershman dhe Hoxha japin këtë histori për të paraqitur një kundërvështrim ndaj përkrahjeve bashkëkohore të “islamit të dhunshëm dhe antisemitizmit... të portretizuara kaq shpesh në media”, kjo histori ka të bëjë po aq me paraqitjen e së kaluarës sa edhe të tashmes.⁶ Për shkak të mungesës së materialit mbi këtë temë, qoftë në formë arkivore apo kërkimore (Perez 2013), projektet e historisë gojore bëhen një burim i rëndësishëm për të portretizuar mënyrën se si në atë kohë familjet shqiptare dhe shteti krijuan lidhje me Holokaustin, portretizim i cili ka peshë në kontekst global, veçanërisht atë të Evropës Perëndimore sot.

Gjatë punës etnografike në terren në vitet 2017 dhe 2018 në Shqipëri, kam parë se si kujtesa e Holokaustit zbatohet ndryshe – si diçka e lidhur me kulturën materiale të periudhës socialiste të vendit nga viti 1944 deri në 1991. Vendet e errëta të trashëgimisë, si ish-burgjet, kampet e punës dhe objektet e internimit, ndonjëherë krahasoheshin publikisht ose fliteshin për lidhjen e tyre të imagjinuar me vendet e njohura të Holokaustit, pavarësisht distancës së tyre kohore dhe hapësinore të dokumentuar dhe të njohur nga ky i fundit. Shembulli më i dukshëm që marr në këtë punim është ish-kampi i internimit në Tepelenë i gjendur në jug të Shqipërisë. Përmes një sërë debatesh rreth historisë së kësaj hapësire dhe trashëgimisë bashkëkohore të cilat ndodhën gjatë punës sime në terren, Kampi i Tepelenës mori emrin jozyrtar Aushvici Shqiptar ose Albanian

Auschwitz.

Kampi i Tepelenës filloi si një kamp internimi i periudhës së hershme socialiste për familjet shqiptare pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, fitores së Frontit Nacional Çlirimtar të Shqipërisë dhe vendosjes së një qeverie vendase të udhëhequr nga Partia Punës. Meqenëse ka pak dokumente administrative që përshkruajnë kampin, historianët shqiptarë janë mbështetur më shumë në dëshmitë e të mbijetuarve të kampit të paraqitura në projektet bashkëkohore të historisë gojore ose në kujtimet e botuara që nga vitet 1990. Këto rrëfime historike janë mbështetur gjithashtu në raporte të hapura të inteligjencës së huaj nga vitet 1950 që bazohen në rrëfimet e të mbijetuarve të kampit nga ajo periudhë kohore. Në bazë të këtyre rrëfimeve, Kampi i Tepelenës paraqitet si një vend ku mbaheshin në kushte të këqia jetese familjet e dezertorëve ushtarakë dhe të arrestuarëve për arsye politike ose të tjera, veçanërisht gratë, fëmijët dhe të moshuarit, pasi qeveria kishte konfiskuar tokën dhe pasurinë e tyre (Dervishi 2015, 12). Përderisa kjo hapësirë shërbeu fillimisht si kazermë për ushtrinë italiane gjatë pushtimit të Shqipërisë nga Italia gjatë kohës së luftës, gjatë punës sime etnografike në terren në 2017 dhe 2018 nuk u shfaq asnjë rrëfim historik që lidhë kampin e Tepelenës me gjenocidin e popullsisë hebreje evropiane gjatë Luftës së Dytë Botërore ose ndonjë lidhje tjetër e drejtpërdrejtë me kampet e përqendrimit të Holokaustit si Auschwitz-Birkenau. Në këtë rast, referencat për Holokaustin në debatet bashkëkohore përshfaqen si një mënyrë për të kuptuar dhe për t'u dhënë kuptim rrëfimeve të vuajtjeve dhe viktimizimit të shqiptarëve të një periudhe të ndryshme historike e cila gjendet ende figurativisht dhe fjalë për fjalë “në errësirë”.

Në këtë punim, unë i jap kuptim këtyre rrëfimeve të ndryshme, të cilat lidhin Shqipërinë me kujtesën e Holokaustit përmes bashkimit të kornizës së kujtesës kozmopolite të Levy dhe Sznajder me konceptin për përvetësimin e kujtesës të Jelena Subotić-it. Holokausti nuk konsiderohet vetëm një tragjedi gjermano-hebreje, por një tragjedi e vetë modernitetit dhe si ushqim për një kulturë të kujtesës globale kozmopolite që shkon përtej lidhjeve kombëtare dhe/ose etnike (Levy dhe Sznajder 2002, 88). Rrëfimet e Holokaustit janë gjithashtu të gatshme për përvetësim, pasi që aktorë dhe shtete specifike kombinojnë dhe ripërpunojnë kujtesën historike për të siguruar qenien e tyre ontologjike si lokalitete, shtet-kombe, apo edhe entitete më të mëdha, si Evropa. (Subotić 2019). Njëpërmjet kësaj kornize, unë argumentoj se të dy zaptimet e kujtesës së Holokaustit në Shqipëri, megjithëse në pamje të parë duken shumë të ndryshme, janë rezultat i dy proceseve të ndërlidhura dhe të vazhdueshme: përpjekjeve për t'u *ballafaquar*, ose përballur me të kaluarën socialiste të pasluftës në Shqipëri dhe përpjekjet për të marrë pjesë në ndërtimin dhe sigurimin e një skeme kujtese pan-evropiane, që thekson identitetin e Shqipërisë si shtet-komb dhe vendin e saj në Evropë.

Përpjekjet për t'u *ballafaquar* me të kaluarën socialiste të vendit janë vazhdimësi e fillim-viteve 1990, gjë që bashkon një përzjerje kujtimesh dhe përvojash personale të asaj periudhe me pritshmëritë dhe zhgënjimet e koncepteve politike, si demokracia dhe drejtësia në të tashmen. Ndërsa shumë shqiptarë kishin shpresuar se grupi i parë i gjyqeve penale do të siguronte drejtësi për viktimat e ekzekutimeve dhe internimeve të detyruara në vende si kampi i Tepelenës, kjo shpresë u zbeh kur anëtarët e nomenklaturës u dënuan vetëm për akuza të zakonshme si shkelje ekonomike. (Austin

dhe Ellison 2008; Kalemaj 2021) Kjo mospërputhje mes pritshmërive dhe rezultateve ka krijuar bazat për një debat të gjallë, të vazhdueshëm dhe haptazi të politizuar rreth historiografisë së shekullit të njëzetë dhe se çfarë roli (ose rolesh) mund të luajë ajo në përcaktimin e pozicionit socio-politik të Shqipërisë në Evropë, veçanërisht në atë të Bashkimit Evropian. Më se me rëndësi është politizimi i kësaj historie të pasluftës, të epokës socialiste në Shqipëri që krijon hapësirë për përvetësime të dallueshme të kujtesës së Holokaustit.

Mes kujtesës kozmopolite dhe përvetësimit të kujtesës

Të shkruash për kujtesën e Holokaustit do të thotë të shkruash për një formë kujtese e cila shkon përtej kufijve etnikë dhe kombëtarë dhe sjellë në jetë skenarë si ai që hapi këtë shkrim - shfaqjen e një bashkëpunimi filmik shqiptar mysliman dhe hebre amerikan në Vankuver të Kanadasë. Kjo është premisa themelore e argumentit të Daniel Levy dhe Natan Sznajder për konceptin e kujtesës kozmopolite, për të cilin ata argumentojnë se përfaqëson formën që merr kujtesa kolektive ose grupe kur ajo ndahet ose shpëputet nga historitë kombëtare përballë globalizimit dhe transnacionalizmit (Levy dhe Sznajder 2002, 89). Ndonëse e shoh kujtesën kozmopolite si një koncept të dobishëm për të gjurmuar rrëfimet e degëzuara të Holokaustit në kontekstin shqiptar, unë mendoj se duhet parë dobinë e kujtesës së Holokaustit si një diskurs që transformohet për të përmbushur nevojat e ndërmjetësve të tij. Pa dyshim se Holokausti është pjesë e një terreni evropian transnacional, siç argumentojnë Levy dhe Sznajder (2002). Megjithatë, nëpërmjet zbatimit të tij, ose thënë më mire nëpërmjet përvetësimit, rrëfime të tilla kujtese janë njëkohësisht në varësi dhe në disa raste përforcojnë kufijtë etnikë dhe kombëtarë.

“ ‘Paskujtesa’ ” përshkruan marrëdhënien që ‘gjenerata pas’ krijon me traumën personale, kolektive dhe kulturore të atyre që jetuan më parë - me përvojat që ata ‘kujtojnë’ vetëm me anë të tregimeve, imazheve dhe sjelljeve mes të cilave ata u rritën.” (Hirsch 2012, 5 – theksimi i saj).

Kujtime të tilla, të mësuara përmes “shqyrtimit imagjativ” (Hirsch 2012, 5), mjegullojnë kufijtë midis kujtesës sociale dhe historike të Halbwach-ut dhe i japin ndoshta edhe më shumë peshë rolit që mund të luajë përfaqësimi në ndërtimin e një kujtese kozmopolite të Holokaustit.

Levy-t dhe Sznajder-t (2002) u interesojnë zbatimet e ndryshme të kulturës së Holokaustit duke u mbështetur në shembuj nga një sërë kontekstesh në mbarë botën, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, Izraeli dhe Gjermania. Por, më tepër mund të thuhet rreth motiveve për përvetësimin e kujtesës së Holokaustit në kontekstin e Evropës (jug)lindore. Siç e parashtron qartë Katherine Verdery (1996, 38) në traktatin e saj mbi ngritjen dhe rënien e socializmit evropiano-lindor dhe sovjetik, efektet e kolapsit të socializmit nuk nënkuptojnë vetëm një “përmbysje masive politike dhe ideologjike... të kufizuara në Lindje”. Fundi i Luftës së Ftohtë përfaqësoi një moment kyç për ndërtimin dhe institucionalizimin e një kulture kujtese kozmopolite për aktorët evropianë, euroaziatikë dhe ndërkombëtarë, që ishin përfshirë në konflikt të gjatë (Levy

dhe Sznajder 2002, 96). Për të ilustruar këtë pikë, Levy dhe Sznajder (2002, 97-98) përdorin shembullin e përfshirjes ndërkombëtare në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, ku reagimi ndaj Luftës së Kosovës vendosi tonin përfundimtar për dekontekstualizimin dhe deterritorializimin e Holokaustit në peisazhin e kujtesës evropiane. Faktorët ndërkombëtarë, përfshirë Gjermaninë, e justifikuan ndërhyrjen e tyre si një detyrim moral nxjerrur nga “mësimet e Holokaustit”. Ky shembull nxjerr në pah përvetësimin e kujtesës së Holokaustit në kontekstin e mirëfilltë të Evropës Juglindore dhe thekson se kujtesa kozmopolite është e lidhur me kornizën euro-perëndimore të të drejtave të njeriut; megjithatë, ajo i vë në pah vetëm zërat e ndërhyrësve dhe jo ato të kosovarëve apo të tjerëve të përfshirë në konfliktin në terren. Krejt në fund mbetet pyetja se nga çfarë përbëhet Evropa dhe si përshtaten vende si Shqipëria dhe Kosova brenda kornizës së kujtesës kozmopolite?

Politikologja Jelena Subotić ofron përgjigjen e kësaj pyetjeje duke vënë në plan të parë Zërat e Evropës Lindore në projektin e kujtesës kozmopolite dekada pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe projektit socialist evropian, dhe më shumë se gjysmë shekulli pas Holokaustit dhe Luftës së Dytë Botërore. Në librin e saj *Red Star, Yellow Star* (Ylli i Kuq, Ylli i Verdhë), Subotić (2019) zhvillon konceptin e përvetësimit të kujtesës për të mundësuar ndjekjen e trajektoreve të ndryshme të kujtesës së Holokaustit dhe përfaqësimin e tij në Serbi, Kroaci dhe Lituani. Në vija të trasha, për Subotić (2019, 9) përvetësimi i kujtesës i referohet përdorimit të kujtesës së Holokaustit për të memorizuar një lloj tjetër vuajtjeje, të lindur nga ankthi ontologjik që rrjedh nga trashëgimia e vazhdueshme e logjikave binare të Luftës së Ftohtë dhe, në rastin e ish-Jugosllavisë, viktimizimit etnik shkaktuar nga shpërbërja e saj. Përmes përvetësimit ose përfaqësimit, aktorët i zhvendosin rrëfimet e vuajtjeve larg grupeve të viktimizuara gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe Holokaustit dhe i përafrojnë ato në rrëfimet e vuajtjeve të lidhura më gjerësisht me shekullin e njëzetë. Në Serbi, aktorët politikë përmbysin kujtesën e Holokaustit për tu fokusuar në krimet e komunizmit dhe vuajtjet e serbëve etnikë; ndërsa, në Kroaci Holokausti bëhet një problem vetëm nazist ose gjerman, dhe në Lituani Holokausti dhe periudha socialiste futen nën dimensionin e terrorit (Subotić 2019, 25-6). Gjendur mes yllit të kuq të komunizmit dhe yllit të verdhë të Davidit, shtetet postsocialiste përvetësojnë rrëfimet dhe simbolet e Holokaustit në mënyra të ndryshme për të përforcuar vendin e tyre në Evropën Perëndimore dhe për të riafirmuar identitetet e tyre pa komunizëm. Mbetet ende për tu gjurmuar se si aktorët brenda dhe jashtë Shqipërisë përdorin kujtesën kozmopolite të Holokaustit.

Më se me rëndësi, përvetësimi i kujtesës brenda kujtesës kozmopolite ka potencial të ndihmojë studiuesit të cilët fokusohen në kontekste të tjera evropiane që të lëvizin ndërjmet niveleve të ndryshme nga ato globale dhe transnacionale në ato kombëtare dhe lokale - të gjitha me synimin për të kuptuar nga perspektiva të ndryshme se si aktorët kombinojnë dhe ripërpunojnë rrëfimet e kujtesës në kushtet e veta dhe drejt qëllimeve specifike. Në vazhdimësinë e pas Luftës së Ftohtë, siguria ontologjike ose ruajtja e ndjenjës së grupit për veten (David 2018) është në rrezik për të gjithë aktorët e përfshirë evropianë – ata transnacionalë, kombëtarë apo të tjerë. Edhe pse Levy dhe Sznajder (2002, 92) pretendojnë se perspektivat kombëtare nuk zhduken përballë globalizimit ose kulturës globale të kujtesës, është e rëndësishme të dihet se si kozmopolitanizmi mund të ndikojë në kategorizim dhe diferencim. Për sociologen Lea David, kur kultura

e kujtesës kozmopolite e përqendruar tek të drejtat e njeriut përhapet globalisht, kategoritë si nacionalizmi dhe përkatësia etnike bëhen më të spikatura. Me presionin në rritje nga aktorët ndërkombëtarë për të përkujtuar mizoritë si spastrimi etnik i lidhur me shpërbërjen e Jugosllavisë, David (2020, 4, 10) tregon se si shoqëri të tilla përjetojnë më shumë destabilizim ndërsa ndarjet etnike përforcohen nga mekanizmat e të drejtave të njeriut ose kur agjentët e fuqishëm shtetërorë zbatojnë agjendat e tyre politike. Duke i kushtuar vëmendje niveleve të ndryshme, unë përdorë përvetësimin e kujtesës si thjerrzë për të gjurmuar se si aktorë të ndryshëm vendës dhe ndërkombëtarë përdorin rrëfimet e deterritorializuara dhe të dekontekstualizuara të Holokaustit në Shqipëri për të përforcuar atë se çfarë do të thotë të jesh shqiptar, evropian, dhe kozmopolit sot.

Shqipëria dhe Holokausti: “Asnjë hebre nuk vdiq”⁷

Në pranverën e vitit 2022, një grup i shquar i diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara ishte një nga 140 përdoruesit që ndanë një skanim të dixhitalizuar të pasaportës së Albert Einstein në platformën Facebook. Në mbishkrimin e tyre shkruhej:

Në mënyrë që Ajnshtajni të vinte në SHBA, ai fillimisht mori dhe [sic] dokument udhëtimi shqiptar gjatë holokaustit [sic], qëndroi në Durrës për rreth 1 muaj në Pallatin Mbretëror Shqiptar përpara se të mbërrinte në SHBA. /Më në fund ato dokumente janë gjetur./ Po të mos ishin shqiptarët, është e mundur që mendja më e madhe që ka ekzistuar ndonjëherë... të mos kishte ekzistuar fare!

Ndonëse ka shumë pak burime që mbështesin lidhjen Ajnshtajn-Shqipëri, shumë prej të cilave vazhdojnë të kontestohen, siç dëshmohet nga debati që pasoi në seksionin e komenteve të këtij postimi,⁸ historia e Ajnshtajnit vazhdon të rishfaqet në mediat online dhe madje edhe në burime akademike.⁹ Për shkak të qëllimeve të këtij artikulli, mua nuk më shqetëson vërtetësia e lidhjes Ajnshtajn-Shqipëri; në vend të kësaj jam e interesuar në fuqinë e këtij tregimi, fuqi e cila paralelizon rrëfimin e përhapur të lidhjes së drejtpërdrejtë të Shqipërisë me Holokaustin në një mjedis të pasluftës, post-socialist, madje edhe kozmopolit. Që nga mesi i viteve 1990, aktorët vendës dhe ndërkombëtarë, nga studiuesit tek mediat tek politikanët vendës dhe diplomatët e huaj, e kanë portretizuar rolin e Shqipërisë në Holokaust si një vend që ishte “strehë e sigurt për hebrejtë” (Perez 2013, 30) – bazuar në popullsinë e vogël hebreje të paraluftës si dhe qindra e mijëra hebrejtë të lindur jashtë vendit që kaluan tranzit nëpër këtë vend gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ndonëse ky rrëfim bazohet në dëshmitë e historisë gojore si dhe kërkimet arkivore të asaj periudhe, në këtë punim unë paraqes se si ky rrëfim pasqyron gjithashtu marrëdhënien komplekse të Shqipërisë me të kaluarën e saj të afërt socialiste dhe përpjekjet e politikanëve dhe studiuesve vendës, si dhe të huajve për të ridefinuar Shqipërinë si një vend përplot njerëzi në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, një rrëfim ky që gjen vend në projektin evropian të kujtesës transnacionale.

Vlen të përmendet sentimentin e shumëcituar në studimet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e Shqipërisë me Holokaustin, i thënë nga ish-diplomati gjerman në Shqipëri, Bernd Borchardt (2022, 81): “Shqipëria ishte i vetmi vend i pushtuar nga Wehrmacht-i gjerman, në të cilin shumë më tepër hebrenj jetuan pas luftës se sa para saj...

Pothuajse të gjithë hebrenjtë në Shqipëri u shpëtuan, një përpjekje kjo e admirueshme”. Për të parë statistikat e pranisë hebreje në Shqipëri shumica e studimeve historike citojnë të dhënat e regjistrimit dhe dokumentet e administratës shtetërore nga vitet 1930 dhe 1940 dhe disa mbështeten gjithashtu në të dhënat e historisë gojore (Luku 2019), pak burime përpiqen të kapin një pamje tërësore ose më të thellë të pranisë hebreje në rajon në mënyrë që këto shifra të kontekstualizohen.¹⁰ Gjatë periudhës në mes të luftëve në Shqipëri, studiuesit dokumentojnë një komunitet të vogël prej rreth 200 hebrenjsh në Shqipëri me vetëm 191 të regjistruar deri në mars 1937 (Dell’Era 2021, 314) - përfundimisht ky numër përbën një pjesë të vogël të kësaj popullsie prej rreth 803,000 në Shqipërinë e paraluftës (Luku 2019, 33). Më vonë, në pushtimin e Italisë, më 1939, dhe më vonë të Gjermanisë, më 1943, Shqipëria, ndryshe nga fqinjët e saj në rajon, përjetoi një rritje dramatike të banorëve dhe refugjatëve të huaj hebrej nga Hungaria, Austria, Gjermania, Greqia dhe ish-Jugosllavia. Historianët kanë debatuar rreth numrit të hebrenjve të lindur jashtë që kaluan tranzit ose u fshehën në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ekziston një konsensus i përgjithshëm se qindra deri në mijëra mund të kenë gjetur një shtëpi të përkohshme në këtë vend. Statistikat e administratës italiane në qershor të vitit 1943 (Perez 2013, 26) paraqesin një popullsi jovendase hebreje në Shqipëri deri në 1000 njerëz. Qendra Botërore e Përkujtimi të Holokaustit të Izraelit Yad Vashem përfshin një numër total prej 600 njerëz deri në fillim të luftës, me disa qindra refugjatë të tjerë që hynë nga ish-Jugosllavia në Shqipëri në periudhën e mëvonshme të luftës¹¹ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Shqiptare paraqiti një listë prej 2,394 emrash hebrej në Muzeun Përkujtimor të Holokaustit të Shteteve të Bashkuara në 2005. (Borchardt 2022, 84)

Megjithatë, siç kanë vënë në dukje studiuesit e studimeve shqiptare dhe të Holokaustit së kohëve të fundit, ekziston një mungesë e studimeve që gjurmojnë historinë shqiptare gjatë dhe para Luftës së Dytë Botërore. Kjo vështirëson që të kuptohet në thellësi marrëdhëniet shqiptaro-hebraike gjatë Holokaustit dhe, në fund të fundit, të kuptohet rrëfimi i strehës së sigurt (Perez 2013, 51; Kedem-Tahar 2014, 19; Borchardt 2022, 84; Duka 2021, 299). Për historianin Daniel Perez (2013, 28-9), i cili ofron një analizë të hollësishme të politizimit dhe përvetësimit të rrëfimit të Holokaustit në Shqipëri deri në vitin 2013, këto shifra shpesh fokusohen në numrat e të mbijetuarëve në Shqipëri dhe përjashtojnë zonat e aneksuaruara (p.sh. pjesë të Kosovës) nga fuqitë e boshtit gjatë luftës – duke hequr një numër më të madh të hebrenjve që humbën jetën në Kosovë. Përderisa studiuesit kanë kryer analiza më të hollësishme të burimeve arkivore shqiptare dhe italiane duke adresuar këtë boshllëk në literaturë (shih Dell’Era 2021; Borchardt 2022), gjithsesi mbetet ende i paqartë roli që autoritetet shqiptare mund të kenë luajtur në deportimet gjermane gjatë konfliktit shqiptaro-serb në Kosovën e kohës së luftës (Perez 2013, 29), edhe nëse të njëjtat autoritete kanë vazhduar të lëshojnë viza, të japin shtetësi, të falsifikojnë dokumente, të transferojnë refugjatë ose të refuzojnë të ndajnë listat me forcat gjermane në kontekstin e Shqipërisë.¹² Sipas dokumentacionit gjerman dhe italian, “më shumë se 1000 hebrenj u arrestuan në territorin e Republikës së Kosovës së sotme” dhe të paktën 92 nga 264 të burgosur hebrej të dokumentuar nga Prishtina u transferuan në Kampin e Përqendrimit Gjerman Bergen-Belsen, më 5 qershor 1944 ku edhe vdiqën (Borchardt 2022, 87).¹³ Studiuesja shqiptare Valentina Duka (2021) sugjeron se sfida e studimit të lidhjes Holokaust-Shqipëri buron pjesërisht

nga pozita fillestare e kësaj fushe, e cila u ngrit në vitet 1990 pas kolapsit të projektit socialist europian dhe gati gjysmë shekulli pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas Dukës (2021, 299) “gjatë epokës komuniste, historiografia shqiptare harroi apo pati pak interes për studimin e Holokaustit apo edhe mbrojtjen e hebrenjve”. Dhe ndërsa Holokausti është bërë një temë studimi në tre dekadat e fundit, siç tregon Perez (2013, 51), ai ende zë një vend skajor në rrëfimin e Shqipërisë së shekullit të njëzetë dhe në përpjekjet këtij shekulli për tu ballafaquar me të kaluarën, gjë të cilën do ta shqyrtoj në seksionet vijuese.

Pavarësisht këtyre boshllëqeve dhe ndoshta për shkak të tyre, studiuesit shqiptarë janë përpjekjur që thelbësisht të përcaktojnë rrënjët e rrëfimit të strehës së sigurt (Duka 2021, 305), e cila ka marrë shumë apel shtetëror dhe ndërkombëtar që nga vitet 1990 dhe mbështetet shumë në dëshmi gojore të familjeve shqiptare që shpëtuan hebrenjtë në Shqipëri. Ndonëse janë identifikuar një sërë faktorësh për këtë, shumë shpjegime kërkuar përgjigje në natyrën dhe/ose zakonet e vetë shqiptarëve. Disa figura të shquara në këtë fushë si Shaban Sinani kanë promovuar një “qasje të sjelljes sociale të bazuar në racë” (Perez 2013, 40) duke argumentuar se njerëzit me “etno-tipin” shqiptar kanë predispozitë të mbrojnë ata që janë në rrezik;¹⁴ ndërsa të tjerët si Nika dhe Vorpsi (2006) e kanë parë sfondin e harmonisë fetare në vend si shtysë për të mirëpritur ata të besimit hebre. Një nga teoritë më të promovuara nga politikanët, të huajt dhe mediat anon nga tradita kulturore dhe njerëzia e shqiptarëve. Në studimin e parë monografik për marrëdhëniet shqiptaro-hebraike të botuar për herë të parë në vitin 1996, Apostol Kotani (2007, 77) u bazua në Kanunin e Lekë Dukagjinit, kanunin më të hershëm të kodifikuar të traditës gojore të Shqipërisë veriore, për të shpjeguar se shoqëria shqiptare kishte një detyrim për të mbrojtur mysafirët e tyre hebrenj sipas normave të mikpritjes dhe besës. Sipas autorëve, Cara dhe Margjeka (2015, 179), të ndash shtëpinë dhe të mbrosh mysafirët edhe pasi ata të largohen, sipas Kanunit, merret shumë seriozisht. Premtimi i një shqiptari për të nderuar mysafirët e tij shtrihet përtej varrit, që do të thotë se çdo ankesë ose e dicka e padëshirueshme që u ndodh mysafirëve duhet të hakmerret ose të parandalohet madje edhe me çmimin e jetës së dikujt më mënyrë që të shmanget shkatërrimi ose çnderimi (Cara dhe Margjeka 2015, 180). Për Kotanin (2007, 85), përballë kërkesave të ushtrisë gjermane për listat e banorëve hebrenj, përgjegjësia e mbrojtjes së këtyre mysafirëve shtrihet përtej vullnetit të mirë të familjeve për shoqërinë në tërësi.

Argumenti i Kotanit për parimet tradicionale të mikpritjes dhe besës ka arritur popullaritet të madh, veçanërisht në rrëfimet e shekullit të njëzetë të formësuara nga elita politike lokale dhe aktorët europerëndimorë (Perez 2013). Një shembull i dukshëm është puna e fotografit dhe historianit amator hebre amerikan Norman Gershman që nxiti shfaqjen e filmit në Vankuver, Kanada, i cili u paraqit në hapje të këtij artikulli. Fymëzuar nga përpjekjet e shqiptarëve për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Holokaustit, Gershman-i nisi një udhëtim në fillim të viteve 2000 për të takuar, fotografuar dhe intervistuar disa nga ato familje. Gjatë projektit, ai dokumentoi përpjekjet e gjashtëdhjetë e pesë familjeve shqiptare myslimane, shumë prej të cilave shpallura si “Të drejtët e kombeve” – një emërtim nderi i dhënë “johebrenjve që rrezikuan jetën e tyre për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Holokausti nga Yad Vashem”.¹⁵ Libri, filmi dhe ekspozita online e Gershman-it në faqen e internetit Yad Vashem¹⁶ janë të gjitha të emërtuara sipas “parimit të lashtë dhe

të shenjtë shqiptar... Besa...”, siç pohon ish-drejtor i Yad Vashem Mordecai Paldiel (2008, xiii) i cili shkroi parathënien e librit të Gershman-it. Përderisa përshkrimi i tij i besës vjen nga dëshmitë gojore të të intervistuarve, është e rëndësishme të theksohet se ai në të njëjtën kohë thjeshton ose kondenson subjektivitetin shqiptar, konceptin e besës dhe marrëdhëniet historike të vendit me pushtimin fashist: shqiptarët reduktohen në nëngrupin e popullsisë që praktikon Islamin; besa bëhet një sjellje ekskluzivisht islame (shih Paldiel 2008); dhe ky rrëfim fillon si përgjigje ndaj pushtimit gjerman të vendit në 1943.

Parlamenti shqiptar adoptoi në vitin 2004 Ditën e Përkujtimit të Holokaustit të caktuar më 27 janar në përvjetorin e çlirimit të Aushvic-Birkenau,¹⁷ dhe, siç tregon Perez (2013), kjo është bërë një platformë për politikanët shqiptarë që t’i qasen premtimit të rrëfimit së strehës së sigurt për audiencën vendase dhe të huaj. Ndërsa Fatos Nano theksoi rezistencën e mirëqenë të popullit shqiptar ndaj ksenofobisë dhe të fliste për sfidat që ata duhej të kapërcenin në vitin 2005 (Perez 2013, 37), adresimet më të vona politike kanë përforcuar nocionin e besës. Më pak se një muaj pas Ditës së Përkujtimit të Holokaustit në 2023, qeveria shtetërore dhe bashkiake në Tiranë shpallën një konkurs ndërkombëtar për të projektuar, kuruar dhe krijuar dy muze të rinj që do t’i kushtoheshin historisë së Holokaustit të Shqipërisë – njëri në Tiranë, tjetri në qytetin port të Vlorës. I titulluar projekti i Muzeut “Besa”, ai premtoi të shenjonte Shqipërinë si “destinacion të historisë së lavdishme të shpëtimit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore”, citim ky nga një pjesë e fjalimit të kryeministrit Edi Rama.¹⁸ Në një komunikim më të mëvonshëm për projektin në faqen zyrtare të Kryeministrit në maj 2023, Rama theksoi rëndësinë e këtyre muzeve si për Shqipërinë ashtu edhe për botën: për shqiptarët, këta muze nënkuptojnë një histori të përbashkët që duhet të ruhet që brezat e ardhshëm që ta dijnë se nga kanë ardhur; dhe për botën, ato nënkuptojnë një mësim që shoqëritë kudo duhet të mbrojnë njerëzimin për të ndërtuar një ndjenjë më të thellë përkatësie mes njëra-tjetrës.¹⁹

Interpretimet vendore, politike dhe të huaja të Historisë së Holokaustit të Shqipërisë, duke përforcuar në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën, krijojnë një hapësirë që miraton një identitet të jashtëzakonshëm dhe unik shqiptar që është, në të njëjtën kohë, pjesë e një kulture më të madhe të kujtesës kozmopolite me kapacitetin për të ofruar shpresë për njerëzimin në një kohë ku shqetësimet për antisemitizmin janë përsëri në rritje.²⁰ Kjo pikë shfaqet ndoshta më së miri në një konferencë multimediale edukative të organizuar nga Misioni i Përhershëm i Shqipërisë në Kombet e Bashkuara dhe Kongresi Botëror Hebre në respekt të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit 2019:

Njohja e veprimit të Shqipërisë si një shembull i guximit moral është një aspekt i rëndësishëm i edukimit dhe përkujtimit të Holokaustit. Veprimi shqiptar mishëron parimet e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut se çdo qenie njerëzore ka të drejtën e patjetërsueshme të trajtohet me dinjitet dhe t’i jepet e drejta për një jetë paqësore dhe të drejtë.²¹

Kampi i Internimit i Tepelenës si Aushvici Shqiptar

Siç u prezantua më parë, Kampi i Internimit i Tepelenës ishte një vend i periudhës së hershme socialiste që funksionoi nga viti 1949 deri në fillim të viteve 1950. Gjatë kësaj

periudhe të shkurtër, kampi strehoi mijëra familje shqiptare – veçanërisht gra, fëmijë dhe të moshuar – pas konfiskimit të tokës dhe pasurisë së tyre nga shteti i sapolindur socialist (Dervishi 2015, 12). Kampi i Internimit i Tepelenës mund të mos ketë strehuar hebrenj gjatë Luftës së Dytë Botërore, por pseudonimi i tij jozyrtar – Aushvici Shqiptar – zbulon se si kujtesa e Holokaustit mund të përdoret për t’i dhënë kuptim humbjeve të një epoke tjetër që janë unike të Shqipërisë, duke shtyrë njëkohësisht kufijtë e projektit të kujtesës kozmopolite pan-evropiane. Politizimi i historisë nga mesi deri në fund të shekullit të njëzetë dhe mungesa e dokumentacionit historik e shfaqur në këtë shembull ofron hapësirë për manipulime të dallueshme të rrëfimeve të kujtesës së Holokaustit dhe debateve publike që pasojnë rreth atyre manipulimeve.

Në një mjedis ku ekzistojnë pak të dhëna administrative që dokumentojnë natyrën e këtij vendi, ato pak të dhëna që ekzistojnë kanë tërhequr shumë interes dhe shqyrtim përgjatë viteve. Gjatë punës sime në terren, historiani dhe ish-kreu i Arkivit të Shtetit Shqiptar, Kastriot Dervishi publikoi një fotografi të një dokumenti administrativ nga arkivi i Ministrisë së Brendshme. Si shumë njerëz të tjerë, e hasa këtë në postimet në Facebook dhe burimet lokale të lajmeve. Tabela e vizatuar me dorë dhe e plotësuar me një shkrim të rregullt përshkruante numrin e burrave, grave dhe fëmijëve që ndodheshin në kampet e internimit si ato në Tepelenë dhe Porto-Palermo gjatë vitit 1950. Grafiku, i cili numëron individët muaj pas muaji, tregon një rënie të madhe të numrit të fëmijëve të internuar në kampin e Tepelenës në vjeshtën e vitit 1950. Ndonëse grafiku nuk tregon se sa ishte përqindja e rënies së popullsisë së shkaktuar nga vdekjet apo transferimet, dëshmitë gojore të të mbijetuarve tregojnë për shkallën e lartë të vdekjeve në mesin e fëmijëve në kamp. Si një artefakt i rrallë fizik i administratës së Kampit të Tepelenës, ky grafik provokon pyetjet e mëposhtme: çfarë lloji jete u ofronte kampi të internuarve të tij, shumë prej të cilëve ishin viktimat të taktikave të hershme të shtetit socialist për të krijuar dhe kontrolluar klasën e armikut të brendshëm në rritje (Këlliçi 2020)? A ishin kushtet e tij të krahasueshme me objektet e tjera të internimit që ishin përhapur në të gjithë Evropën gjatë Luftës së Dytë Botërore?

Ndërsa termi Aushvici shqiptar nuk është emërtim zyrtar i Kampit të Tepelenës, referencat për Holokaustin ose nazizmin janë përhapur në shkrimet shkencore si dhe imagjinatën publike të këtyre vendeve. Në dekadën e fundit, imazhi i kampit të përqendrimit të Holokaustit i ka tërhequr studiuesit shqiptarë për të kuptuar boshllëqet në njohuritë administrative të Kampit të Tepelenës dhe valën e fundit të dëshmimeve gojore të të mbijetuarve të kampit që përshkruajnë fëmijërinë e tyre dhe moshën e rinisë në hapësirë. Në diskutimin e tij për kampet e internimit nga viti 1945 deri në 1953, Kastriot Dervishi (2015, 7) shkruan se kampe të tilla gjendeshin zakonisht në shtetet komuniste dhe ato ishin shumë të ngjashme me kampet e përqendrimit të epokës naziste. Në një intervistë në lidhje me Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve të botuar në vitin 2015, Dervishi madje shkoi aq larg sa të përshkruante objektet e Kampit të Tepelenës si një kamp vdekjeje që ishte drejtuar jo kundër shkelësve të regjimit, por të afërmeve të tyre – bashkëshorteve të dezertorëve ushtarakë, prindërve të të arratisurve, fëmijëve të të burgosurve politikë.²² Politikologu Klejdi Këlliçi (2020) bazohet gjithashtu në terminologjinë e kampit të përqendrimit dhe kampit të vdekjes për të sqaruar se ndërsa këto kampe filluan si objekte internimi ose “pengjesh” për të luftuar kryengritjet politike në një gjendje të paqëndrueshme shtetërore, ato u bënë

shpejt hapësira vdekjeprurëse ku të internuarit përballeshin me urinë, kequshqyerjen dhe ekspozimin për shkak të familjes në të cilën kishin lindur.

Në vitin 2018 shpërtheu polemika rreth çështjes se a mund të krahasohej kampi i Tepelenës me kampet gjermane të përqendrimit apo shfarosjes.²³ Në një transmetim kombëtar, historiani mesjetar Pëllumb Xhufi vuri në pikëpyetje kushtet çnjerëzore të kampit dhe krahasimin e tij me kampet naziste të përqendrimit, duke shkaktuar reagim publik si nga studiuesit ashtu dhe nga individë që i kishin shpëtuar internimit në kampe si Tepelena.²⁴ Historiana Enriketa Papa kritikoi mbështetjen e tepruar të Xhufit në burimet arkivore shtetërore dhe shfrytëzoi rastin të theksojë rolin e rëndësishëm që duhet të luajë historia gojore në ndërtimin e një kulture të kujtesës kolektive.²⁵ Të tjerë si Fatbardha Millet Saraçi, një studiuese më parë e internuar në Kavajë dhe që atëherë ka kryer kërkime mbi përvojat e vuajtjeve të grave gjatë regjimit socialist (veçanërisht në kampin e Tepelenës), u tha gazetarëve nga BIRN se komentet e Xhufit ishin jonjerëzore, veçanërisht “për ata që humbën jetën në burgjet dhe kampet e punës.”²⁶ Nga këto rrëfime të ndryshme të Kampit të Tepelenës fillojmë të kuptojmë se referimi ndaj Holokaustit nuk është kohor (p.sh., një referencë për Tepelenën si një kamp përqendrimi i periudhës së Holokaustit), por një mjet i cili me ndihmën e retorikës për të drejtat e njeriut si psh. kundërvënia ndaj “jonjerëzores” duke theksuar “dinjitetin njerëzor” dhe duke lartësuar “jetën njerëzore,” ndihmon në njohjen e individëve të cilët vdiqën në zonat e padiferencuara shqiptare gjatë periudhës socialiste. Siç vë në pah Jelena Subotić (2019, 25), kujtesa e Holokaustit “bëhet një përfaqësues për të kujtuar diçka tjetër, në këtë rast komunizmin”.

Kampi i Tepelenës ishte një vend traumash dhe humbesh për shumë familje, diçka që shqiptarët, si bashkëbiseduesi im që unë e quaj Reshat (pseudonim), po mësojnë se si të përballen sot. Në fillim të vitit 2018, takova Reshatin, një punonjës i ri i një institucioni shtetëror që studionte krimet e kryera gjatë periudhës socialiste të Shqipërisë. Teksa po bënim një xhiro në zyrën e tij, ai më tha diçka që më ka mbetur në mendje që atëherë: “Edhe fëmijët e vegjël – 1 ose 2 vjeç – i internuan në kushte të tmerrshme. Në Tepelenë thuhet se vdiqën mbi 4000 fëmijë, ndaj ne e quajmë atë [vend] “Aushvici i Shqipërisë”.”²⁷ Katër mijë nuk është një përkrahim i saktë se sa fëmijë apo individë vdiqën në Kampin e Tepelenës. Pllaka përkujtimore në kampin e Tepelenës thotë se atje u shuan 500 individë dhe 300 është shpesh numri i llogaritur i fëmijëve që raportohet t’ua ketë marrur jetën kampi. Duke reflektuar në komentet e tij më vonë, kuptova se Reshata kishte rritur numrin në 4000 sepse kjo jipte ndjesinë e numrit të madh – ashtu siç ndjehet numri i të vdekurve në vende si Tepelena. Mund ta imagjinoja vetëm se ai donte që unë, një antropologe e huaj, të kuptoja peshën e asaj humbjeje kur vizitova vendin, i cili kishte humbur pamjen e tij si një objekt internimi nga improvizimet e bëra gjatë dekadave. Duke i menduar fjalët e Reshatit rishikova shënimet e mia nga vizita ime e parë në 2017 te ish-kampi. Shumë nga ndërtesat e jashtme që rrethojnë vendin qëndronin të ekspozuara pa çati. Ato me çati ishin shndërruar në shtëpi të improvizuara për kafshët e fermës lokale (shih Figurën 01). Dhe ndërsa fëmijët e sotëm nga Tepelena luanin nën hijen e një prej ndërtesave pranë meje, një ish i internuar që kishte kaluar fëmijërinë e tij në kampin e Tepelenës, vizatoi për mua në pluhur një skicë të dhomës së ngjeshur të banimit të familjes së tij. Duke shikuar oborrin qendror, ai kujtoi se si më shumë se gjysmë shekulli më parë kishte parë fëmijët që luanin në Tepelenë – ku disa



Figura 01: Një forografi e bërë nga autorja në gusht 2018, ku paraqitet armatura dhe mbetjet e betonit të një ndërtese në ish-kampin e Tepelenës.

prej tyre për fat të keq nuk i mbijetuan kampit për të treguar historinë e tyre.

Pas vendosjes së një pllake përkujtimore në vitin 2015, organizata e pavarur shtetërore e quajtur Autoriteti i Informimit të Dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit (tani e tutje Autoriteti) përfshiu në mandatin e saj përkujtimin e Kampit të Tepelenës, pasi u themelua në po të njëjtin vit. Kjo do të thoshte se, përveç mbledhjes, hapjes dhe qasjes në dokumentet e sigurisë së ish shtetit socialist, Autoriteti shihte pjesëmarrjen në përkujtimin e viktimave të periudhës socialiste si detyrë shoqërore. Në vitin 2017, Autoriteti ishte nikoqir i asaj që do të bëhej një ngjarje përkujtimore e përvitshme në vendin e vetë kampit e quajtur *Dita Muze/Memorial Tepelenë*. Ngjarja e parë ishte relativisht e thjeshtë dhe kishte një kolektiv të vogël të të mbijetuarve të kampit dhe të anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar diplomatik, ndërsa ngjarja e 2018-ës ishte diçka tjetër. Në partneritet me një mori organizatash si Bashkia e Tepelenës, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri, Ambasada Italiane dhe Ambasada e SHBA ndër tjerash, Autoriteti organizoi një aktivitet që filloi në mesditë dhe zgjati deri në mbrëmje; të ftuarit madje ftoheshin të bënin kamp midis rrënojave nëse dëshironin. Kjo ngjarje nuk ishte vetëm më e madhe se ceremonia e vitit të kaluar; ajo kishte zhvendosur datat nga 30 në 23 gusht që ishte dita e njohur në të gjithë Evropën si Dita Evropiane e Përkujtimit të Viktimave të Totalitarizmit (veçanërisht, nazizmit dhe stalinizmit) e miratuar në 2008.

Data e 23 gushtit shënon një ndryshim në peisazhin kozmopolit të kujtesës, pasi rrëfimet e viktimizimit që kanë të bëjnë me Holokaustin i lënë hapësirë tregimeve të ndryshme të viktimizimit në kontekste të tjera evropiane, veçanërisht atë të socializmit,

apo siç shpesh reduktohet, atë të stalinizmit (Subotić 2019). Parlamenti Evropian zgjodhi këtë datë të veçantë sepse ishte përvjetori i Paktit Molotov-Ribbentrop i vitit 1939 ose dita kur “Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania ndanë Evropën në dy sfera interesash...”, të cilat çuan në “deportime masive, vrasje dhe skllavërime [... që] bien në kategorinë e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.”²⁸ Ombrella e thjeshtuar e viktimave të totalitarizmit inkurajon në vetë kornizën e saj përzierjen e rrëfimeve përkujtimore – të gjitha në shërbim të ndërtimit të një rrjeti aktiv të kujtimit pan-evropian që shërben si masë mbrojtëse kundër përsëritjes së krimeve të shekullit të njëzetë.

Ndërsa elita shqiptare e ka përdorur rrëfimin e Holokaustit për të folur për viktimizimin e shqiptarëve etnikë në kontekste të tjera përpara institucionit së Ditës Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Totalitarizmit (Perez 2013), duke përkujtuar viktimat dhe të mbijetuarit e kampit të Tepelenës tek “Aushvici shqiptar” në po këtë ditë përforcon veçanërisht dekontekstualizimin e kujtesës së Holokaustit që Levy dhe Sznajder kapën me konceptin e kujtesës kozmopolitane përmes hiper-kontekstualizimit të së kaluarës socialiste. Kryetarja e Autoritetit Gentiana Sula paraqiti këtë ndjenjë në fjalimin e saj në ceremoninë e vitit 2018, ku shpjegoi pse Autoriteti kishte zgjedhur të fillonte përpjekjet e tij përkujtimore me Kampin e Tepelenës: “Së pari duhet të përkujtojmë viktimat e të gjitha regjimeve totalitare (përfshirë regjimin stalinist të Shqipërisë)... Dhe në fund, këtu janë krijuar dhe kanë vdekur kaq shumë ish të përndjekur ... Kjo është edhe për ta”.²⁹

Përfundim: Premtimi i praktikave të kujtesës kozmopolitane shqiptare

Figura 02, paraqet një memorial me tre pllaka të ngritura në vitin 2020 për të përkujtuar shpëtimin e komunitetit të vogël hebre në Shqipëri mes humbjes tragjike të gjashtë milionë individëve në të gjithë Evropën. Ndërsa, fotografia e fundit paraqet një pllakë të vetme të vënë në 2015 kushtuar qindra burrave shqiptarë, grave dhe fëmijëve që vdiqën në Kampin e Internimit të Tepelenës në Shqipëri dhe Jugut pas Luftës së Dytë Botërore (shih figurën 03). Nëse monumenti i parë është shndërruar në një pikë referimi në mes të një parku të shquar të Tiranës, ky i fundit ndodhet para vetë kampit në një pllakë betoni të pamirëmbajtur dhe tashmë pak të copëtuar në qoshe në mes të një fushe.

Nëse memoriali i parë bazohet në dëshmi gojore për të zbuluar aktet e fshehura të hirësisë dhe mirësisë, i dyti mbështetet po në dëshmi gojore për të zbuluar aktet e fshehura të shtetit për të fshehur varret e viktimave të tij. Nëse monumenti i parë përkujton fuqinë e njerëzisë në kohë lufte, i dyti ka të bëjë me korrupsionin dhe humbjen e asaj njerëzie në kohë represioni shtetëror. Ndonëse duket se dy monumentet kanë pak të përbashkëta, vetëm duke analizuar ato së bashku fitohet një kuptim më i thellë i kujtesës kozmopolite dhe se si përvetësimi i saj në Shqipëri kontribuon në sigurinë ontologjike të shtetit-komb dhe të Evropës.

Marrëdhënia e Shqipërisë me historinë e shekullit të njëzetë, si dhe me aktorët e tjerë evropianë, megjullon ndarjet mes kategorive të ndryshme të përvetësimit të kujtesës së Subotić-it, duke e bërë atë të dobishme si për rrëfimet e kujtesës specifike për shqiptarët ashtu edhe për ato panevropiane. Përmes rrëfimit “Asnjë hebre nuk vdiq



Figura 02: Fotografji e Memorialit të Holokaustit inauguruar zyrtarisht më 20 korrik 2020 në Tiranë, Shqipëri, e bërë nga autorja. Memoriali, i përbërë nga tre pllaka graniti, tregon në shqip, anglisht dhe hebraisht historinë e përpjekjeve të shqiptarëve për të nderuar besën e tyre duke mbrojtur komunitetin hebre gjatë pushtimit gjerman.



Figura 03: Fotografji e një pllake përkujtimore e vendosur në vitin 2015 në qendër të ish-Kampit të Internimit të Tepelenës e bërë nga autorja.

në Shqipëri”, vihet në lojë puna e divergjencës. Nisur nga kërkimet e kufizuara mbi rolin që mund të ketë luajtur shteti shqiptar në përvetësimin e politikave antisemite të forcave pushtuese dhe paqartësinë e kufijve të tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, rrëfimi i shpëtimit shqiptaro-holokaust përfaqëson një histori të thjeshtuar, por të fuqishme të njerëzimit që përdoret si brenda vendit ashtu edhe më jashtë. Në të njëjtën kohë kur vankuveritasit mbledhen për të parë dokumentarin e Norman Gershman dhe Rexhep Hoxhës “Besa: Premtimi”. Në këtë rast, krimet, fajësimi dhe viktimizimi nuk janë aspak në qendër pasi kujtesa e Holokaustit është zhvendosur për të njohur historitë e të mbijetuarve dhe familjeve shqiptare që strehuan hebrenjtë evropianë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shfaqja e dokumentarit tregon gjithashtu se si një rrëfim i njerëzisë shqiptare, i nxjerrë nga përvetësimi i kulturës së kujtesës së Holokaustit, mund, në këmbim, të kontribuojë në zgjerimin e vazhdueshëm të një kulture të kujtesës kozmopolite të orientuar drejt një të ardhmeje që refuzon antisemitizmin dhe promovon tolerancën fetare.

Përderisa marrëdhënia historiografike e Shqipërisë me Holokaustin fokusohet në mbijetesën, jetën dhe njerëzimin, diskursi i dytë për vetë Aushvicin e vendit prezanton punën e dyfishtë të përmbysjes dhe ngatërimit. Me ndihmën e imazheve të Holokaustit, ish-kampi i internimit të Tepelenës bëhet një vend ku historia e Luftës së Dytë Botërore përshtatet për të treguar një histori të vuajtjeve të shqiptarëve gjatë periudhës socialiste që pasoi. Përderisa disa studiues, personazhe publike dhe ish të internuar kanë argumentuar se krahasimi me kampet naziste të përqendrimit është i rëndësishëm për të ndërmjësuar përvojat e të mbijetuarve të kampeve, debati publik dhe përgjigja ndaj komenteve të historianit Pëllumb Xhufi i cili vuri në dyshim këtë krahasim nxjerr në pah edhe më shumë punën që ky përvetësim i Holokaustit kryen në Shqipëri. Krahasimi mes kampit të Tepelenës dhe kampeve të përqendrimit të periudhës naziste si Aushvic-Birkenau u ofron aktorëve të ndryshëm një kornizë për të diskutuar taktikat e ish shtetit socialist për të kthyer njerëzit e tyre në një klasë armike që ishte *homo sacer*.³⁰ Ky ligjërimit thekson vuajtjen dhe viktimizimin veçanërisht shqiptar. Në të njëjtën kohë, përforcon përpjekjet e fundit të evropianëve për të zgjeruar kulturën e kujtesës kozmopolite përmes përkujtimit të viktimave të totalitarizmit, i cili njëkohësisht thjeshton dhe ndërthur projektet komplekse dhe të ndryshme shtetërore socialiste në të gjithë Evropën me stalinizmin dhe stalinizmin me nazizmin.

Që të dy zbatimet e ndryshme të kujtesës së Holokaustit lindin nga përpjekjet për tu përballur me të kaluarën socialiste dhe efektet e saj në historiografi, një proces i rrëmujshëm që ka vazhduar që nga fillimi i viteve 1990 kur decentralizimi dhe transformimi i shtetit ofroi hapësirën për të rishikuar Shqipërinë si një shtet-komb demokratik. Holokausti përvetësohet në këtë kontekst socio-politik për të treguar Shqipërinë si një komb plot njerëzi dhe një komb me plot vuajtje, si një komb demokratik në lulëzim dhe si pjesë e një rrjeti të kujtesës evropiane në rritje. Përmes promovimit dhe pjesëmarrjes në rrëfimet specifike shqiptare të kujtesës kozmopolite, komuniteti më i gjerë evropian mund të gjejë një shembull të totalitarizmit të shekullit të njëzetë që merr pjesë në zgjerimin/dekontekstualizimin e kulturës së kujtesës së Holokaustit dhe gjen frymëzimin për shtigjet e së ardhmes që theksojnë njerëzinë kur konflikti dhe indiferenca sfidojnë rrëfimin pan-evropian të unitetit.

FUNDNOTAT

1 Hulumtimi për këtë artikull u mbështet bujarisht nga burimet e mëposhtme: (1) Programi Studentor Fulbright, i financuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA dhe i administruar nga Byroja e Çështjeve të Arsimit dhe Kulturës; (2) Titulli VIII Programi Studiues Kërkimor, i financuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së dhe i administruar nga Këshillat Amerikanë për Arsimin Ndërkombëtar; dhe (3) Bursa Junior Postdoctoral në Karl-Franzens-Universität Graz, Programi Fushat e Shkëlqyeshmërisë “Dimensionet e evropianizimit”. Mendimet, gjetjet dhe përfundimet e paraqitura këtu janë të autorës dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit të SHBA-së ose Karl-Franzens-Universität Graz. Më tej, ky punim nuk mund të botohej pa mbështetjen e shumë njerëzve. Dëshiroj të falënderoj kolegët e mi në Karl-Franzens-Universität Graz në programin Fushat e Shkëlqyeshmërisë “Dimensionet e evropianizimit” dhe në Qendrën për Studime të Evropës Juglindore për komentet e tyre mbi një version të këtij punimi të cilin e paraqita në sezonin e verës 2022, Seria e seminareve *Brown Bag* të organizuara nga Fushat e Ekselencës “Dimensionet e evropianizimit”. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj dy recensentët e tekstit kolegë dhe redaktorët nga *Kosova Anthropologica*, të cilët më ndihmuan për të përmirësuar këtë punim për botim. Së fundi, një falenderim i madh shkon për partnerin dhe kolegun tim Jonathan Eaton, i cili lexoi dhe komentoj versione të shumta të këtij punimi dhe i cili më ka ofruar mbështetje të çmuar gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe shkrimit.

2 Ky punim përfshin dhe bazohet në materialin nga disertacioni im i titulluar “Drejhtësia tranzicionale: Përballja me të kaluarën për të pranuar të tashmen në Shqipëri”. Punimi veçanërisht zgjerohet në materialin nga rasti studimor i paraqitur në “Kapitulli 1: Ndërtimi i një monumenti kombëtar për viktimat e periudhës socialiste të Shqipërisë”. (shih Rocker 2022)

3 BBC News. 2018. “The forgotten Swiss diplomat who rescued thousands from Holocaust.” Faqja e internetit e BBC News, 4 janar. Qasur më 3 shtator 2023. <https://www.bbc.com/news/world-europe-42400765>. Blakemore, Erin. 2018. “The Diplomat Who Saved Thousands of Jews During the Holocaust.” History.com, 23 korrik. Qasur më 3 shtator 2023. <https://www.history.com/news/carl-lutz-saved-jews-holocaust-nazis-world-war-ii>.

4 Sarajevo Times. 2019. “How Bosnian Muslim back in 1941 told a Lie and saved Hundreds of Jews in BiH?”. Faqja e internetit e Sarajevo Times, 17 mars. Qasur më 3 shtator 2023. <https://sarajevotimes.com/how-bosnian-muslim-back-in-1941-told-a-lie-and-saved-hundreds-of-jews-in-bih/>

5 Sito-sucic, Daria. 2022. “Film tells of Bosnian Muslims and Jews saving one another in wars.” Faqja e internetit e Reuters, 17 qershor. Qasur më 3 shtator 2023 <https://www.reuters.com/lifestyle/film-tells-bosnian-muslims-jews-saving-one-another-wars-2022-06-17>

6 Besa: Premtimi. N.D. “Filmi”. Besathepromise.com. Qasur më 3 shtator 2023. <http://besathepromise.com/thefilm.html>

7 Citimi është marrë nga një artikull i shkurtër i botuar nga *The Peninsula Daily News* në Port Angeles, Uashington, SHBA në korrik të vitit 2020. Citimi i plotë thotë: “Nazistët vranë 6 milionë njerëz, por Shqipëria ishte i vetmi vend ku nuk vdiq ose nuk është dorëzuar asnjë hebre. Shqiptarët mbrojtën qindra miq hebrenj dhe ndihmuan hebrenjtë e tjerë që ikën nga Gjermania dhe Austria.”

8 Disa nga komentet kundërshtonin elemente specifike si numri i ditëve që Ajnshtajni qëndroi në Shqipëri (“Ai ka ndejtur 3 dite sipas dokumentave! [sic]”), ndërsa të tjera kundërshtonin idenë se Ajnshtajni ka qenë ndonjëherë në Shqipëri duke kritikuar dëshmitë e pasaportës. (“Ky Dokument është Zvicrran jo Shqiptar” [sic].).

9 Në vitin 2009, kosovari Alush Gashi drejtoi dhe publikoi një dokumentar të titulluar Shpëtimi në Shqipëri i cili përfshinte rrëfimin shqiptar për Ajnshtajnin. Në vitin 2013, Dalip Greca botoi artikullin “Albert Ajnshtajni në Shqipëri dhe pasaporta shqiptare” në Gazetën *Dielli* në bazë të

materialit që kishte arritur të gjente për të mbështetur këtë histori. Në vitin 2019, Esilda Luku përfshiu historinë e Ajnshtajnit në hyrje të artikullit të saj mbi motivimet e përpjekjeve të shqiptarëve për të shpëtuar popullin hebre gjatë Holokaustit për Revistën e Historisë Hiperboreea (Luku 2019, 34).

10 Shih Kotani 2007 dhe Duka 2021 për burime që trajtojnë në hollësi historinë e vendosjes së hebrenjve në Shqipëri. Edhe pse, siç thekson Bernard Borchardt (2022, 81), kjo fushë është ende e nënstuduar dhe mund të dokumentohet më mirë.

11 Profili i Shqipërisë në faqen e internetit të Yad Vashem përmbanë pak informacione historike të pacituara që kapin një numër të përgjithshëm neto pozitiv hebrenjsh në Shqipëri, përfshirë vendasit dhe të huajt. Yad Vashem. N.d. “Shqipëria”. Yad Vashem, Uebfaqja e Qendrës Botërore të Përkujtimit të Holokaustit. Qasur më 6 shtator 2023. <https://collections.yadvashem.org/en/about/o5725>.

12 Historianët shqiptarë dhe të huaj zakonisht konsiderojnë këto taktika si mënyra përmes të cilave figurat e autoritetit shqiptar arrinin të përmbysnin politikat antisemite në vend (Shih Luku 2019; Dell’Era 2021; Sinani 2021; Borchardt 2022).

13 Borchardt merr numrat e tij nga baza e të dhënave Yad Vashem dhe libri përkujtimor i Bergen-Belsen.

14 Sinani, Shaban. 2005. “Hebrejtë në Shqipëri dhe shpëtimi i tyre në periudhën naziste.” Shekulli, 27 janar 2005.

15 Yad Vashem. N.d. “FAQs: the Righteous Among the Nations.” Faqja e internetit Yad Vashem. Qasur më 7 shtator 2023. <https://www.yadvashem.org/righteous/faq.html>.

16 Yad Vashem. N.d. “Besa: A Cod of Honor”. Faqja e internetit Yad Vashem. Qasur më 7 shtator 2023. <https://www.yadvashem.org/yv/en/exhibitions/besa/index.asp>.

17 Dita e Përkujtimit të Holokaustit u krijua me Ligjin Numër 9280, miratuar më 23 shtator 2004.

18 Top Channel. 2023. “Shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri / Në Tiranë do ngrihet muzeu ‘Besa.’” Faqja e internetit e Top Channel, 17 shkurt 2023. Qasur më 7 shtator 2023. <https://top-channel.tv/video/top-channel-shpëtimi-i-hebrenjve-ne-shqiperi-ne-tirane-do-ngrihet-muzeu-besa/>.

19 Shih paragrafin 7. Kryeministria. “Muzeu Hebraik Shqiptar, Historia e Rrallë Shqiptare e Shpëtimit të Hebrenjve – Prezantohet Projekti Fitues.” Faqja e internetit e Kryeministrisë, 17 maj 2022. Qasur më 7 shtator 2023. <https://www.kryeministria.al/newsroom/muzeu-hebraik-shqiptar-historia-e-rralle-shqiptare-e-shpëtimit-te-hebrenjve-prezantohet-projekti-fitues/>.

20 Taylor, Alice. 2023. “Albania to open Holocaust Museum after Israeli call for Europe to step up antisemitism fight.” Faqja e internetit Euractiv, 2 mars 2023. Qasur më 7 shtator 2023. <https://www.euractiv.com/section/politics/news/albania-to-open-holocaust-museum-after-israeli-call-for-europe-to-step-up-antisemitism-fight/>.

21 Asia News Monitor. 2019. “United Nations: United Nations to Hold Briefing at Headquarters on Rescue of Jews in Albania during Holocaust, 31 January .” ProQuest, 20 shkurt 2019. <https://www.proquest.com/docview/2183239503?accountid=14244&forcedol=true>.

22 Zëri i shqiptarëve. 2015. “Kastriot Dervishi: Kampi i Tepelenës ishte kamp vdekje – ku u zhdukën 300 fëmijë.” VOAL.ch, Tetor 19, 2015. Accessed September 8, 2023. <https://www.voal.ch/kastriot-dervishi-kampi-i-tepelenes-ishte-kamp-vdekje-ku-u-zhduken-300-femije/multimedia/dossier/>.

23 Veçanërisht, ky zbatim i kampeve të përqendrimit është në kontrast të plotë me përkufizimet e kampeve të përqendrimit që kishin strehuar refugjatë hebrenj në kontekstin e Luftës së Dytë Botërore. Në përputhje me pretendimin e vendit se është mbrojtur popullsia e tij hebreje, disa studiues vendës dhe të huaj kanë argumentuar se kampet e përqendrimit të shqiptarëve të epokës së Luftës së Dytë Botërore, megjithëse ishin bazë, nuk synonin të kufizonin të drejtat e banorëve të tyre hebrenj. Bernard Borchardt (2022, 83) shkruan se “kampet në Shqipëri nuk ishin të

krahasueshme me kampet e përqendrimit në Gjermaninë naziste. Në pjesën më të madhe, të burgosurit mund të lëviznin lirshëm nëpër komunitete dhe qeveria i siguroi të mirat për ata deri në nëntor 1942, megjithëse në një nivel të ulët dhe në kushtet më elementare.

24 Komentet e Xhufit ishin pjesë e një debati mbi historinë/historiografinë shqiptare të shekullit të njëzetë të transmetuar dhe moderuar nga gazeta shqiptare Ora News më 29 mars 2018. Debatin mund ta gjeni të postuar në faqen e internetit Ora News:

<https://www.oranews.tv/article/xhufi-historia-me-nderhyrjet-e-politikes-eshte-deformuar-ne-menyre-te-frikshme>. Diskutimi për Kampin e Tepelenës, i prezantuar nga Pëllumb Xhufi, nis rreth minutës së 43.

25 Pandelejmoni (Papa), Enriketa. 2018. “Debati mbi Tepelenën, kujtesa dhe objektiviteti historik.” Panorama. 15 prill. Qasur më 15 prill 2018

<http://www.panorama.com.al/debati-mbi-tepelenen-kujtesa-mbi-te-dhe-objektiviteti-historik/>

26 Erebara, Gjergji. 2018. “Historiani shqiptar zemëron të mbijetuarit e kampit komunist.” Drejtësia Tranzicionale Ballkanike, Balkan Insight. 30 mars. Qasur më 28 maj 2018. <https://balkaninsight.com/2018/03/30/albanian-historian-angers-survivors-of-communist-camp-03-29-2018/>.

27 Reshati (anëtar i stafit për projektin “Përballja me të kaluarën”), Intervistë gjysmë e strukturuar, 19 janar 2018.

28 Dita Evropiane e Përkujtimit të Viktimave të Stalinizmit dhe Nazizmit, P6_TA (2008)0439.

29 Përafirim i fjalimit të Gentiana Sulës marrë nga shënimet e mia në ceremoninë e Ditës së Përkujtimit të Kampit të Tepelenës më 23 gusht 2018.

30 *Homo sacer*, përdorur nga Giorgio Agamben në teorizimet e tij për politikën e jetës dhe vdekjes në shtetet bashkëkohore, i referohet jetës që mund të vritet, por jo të sakrifkohet. Me fjalë të tjera, nëse dikush vranë një homo sacer kjo nuk do të njihej si vrasje, pasi trupi dhe imazhi i homo sacer nuk përfaqëson më jetën që duhet të mbrohet ose të ruhet si e shenjtë (Agamben 1998, 47). Për të bërë këtë dallim Agamben bazohet në Muselmann-in e famshëm të kampeve gjermane të përqendrimit. I vuajtur nga lodhja ekstreme dhe uria, Muselmann mishëron jetën në formën e saj më të zhveshur – një jetë që nuk ka asocime politike dhe që pret një vdekje joceremonike (Agamben 2003).

BIBLIOGRAFIA

Agamben, Giorgio. 1998. *Homo Sacer*. US: Stanford University Press.

Agamben, Giorgio. 2003. *Remnants of Auschwitz, the Witness and the Archive*, trans. Daniel Heller-Raozen. US: Zone books.

Austin, Robert C. and Jonathan Ellison. 2008. “Post-Communist Transitional Justice in Albania.” *East European Politics and Societies*, 22(2): 373-401.

Borchardt, Bernd. 2022. “Protection for Jews and Persecution of Jews in the Albanian-speaking Area during World War II: An Overview of the Current State of Research.” *Südosteuropa Mitteilungen*, 4: 79-90.

Bourdieu, Pierre. 1977. *Outline of a Theory of Practice*. Translated by Richard Nice. Cambridge: Cambridge University Press.

Cara, Arben and Mimoza Margjeka. 2015. “Kanun of Leke Dukagjini Customary Law of Northern Albania.” *European Scientific Journal*, 11(28): 174-186.

Connerton, Paul. 1989. *How Societies Remember*. Cambridge: Cambridge University Press.

Dervishi, Kastriot. 2015. *Burgjet dhe Kampet e Shqipërisë Komuniste*. Tiranë: ISKK.

David, Lea. 2018. “Policing Memory in Bosnia: Ontological Security and International

- Administration of Memorialization Policies.” *International Journal of Politics, Culture, and Society*, 32: 211-225.
- David, Lea. 2020. *The Past Can't Heal Us: The Dangers of Mandating Memory in the Name of Human Rights*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Dell’Era, Tommaso. 2021. “The Italian Occupation of Albania: Fascist Albania and the Persecution of the Jews (1939-1943)” *The Jewish Question in the Territories Occupied by Italians, 1939-1943*, edited by Giovanni Orsina and Andrea Ungari (309-331), Viella.
- Duka, Valentina. 2021. “Albanian Historiography and the Holocaust” *The Jewish Question in the Territories Occupied by Italians, 1939-1943*, ed. Giovanni Orsina and Andrea Ungari (299-308), Viella.
- Halbwachs, Maurice. 1992. *On Collective Memory*. University of Chicago Press.
- Hirsch, Marianne. 2012. *The Generation of Postmemory: Writing and Visual Culture after the Holocaust*. New York: Columbia University Press.
- Kalemaj, Ilir. 2021. “Transitional Justice and Democratic Consolidation in Post-Communist Eastern Europe: Romania and Albania.” *Eastern Journal of European Studies*. 12(1): 81-103.
- Kedem-Tahar, Efrat. 2014. “The Contribution of Establishing Holocaust Study in Albania.” *SEA – Practical Application of Science Volume II*, 3(5): 17-24.
- Këlliçi, Klejd. 2020. “Defining the Internal Enemy: Detention Camps in Early Communist Albania, 1945–1950.” *Pamięć i Sprawiedliwość*, 36(2): 138-152.
- Kotani, Apostol. 2007. *Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj*. Tiranë: Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Izrael.
- Levy, Daniel and Natan Sznaider. 2002. “Memory Unbound: The Holocaust and the Formation of Cosmopolitan Memory.” *European Journal of Social Theory*, 5(1): 87-106.
- Luku, Esilda. 2019. “Why Did Albanians and their Collaborationist Governments Rescue Jews during the Holocaust?” *Hiperboreea - Journal of History*, 6(2): 33-49.
- Nika, Nevila and Liljana Vorpsi. 2006. *Guidebook: A Reference to Records about Jews in Albania before, during, and after the Second World War*. Tirana: Pegi.
- Paldiel, Mordecai. 2008. “Foreword.” *Besa: Muslims Who Saved Jews in World War II*. Syracuse University Press: Syracuse, New York.
- Perez, Daniel. 2013. “Our Conscience is Clean,” Albanian Elites and the Memory of the Holocaust in Postsocialist Albania.” *Bringing the Dark Past to Light: The Reception of the Holocaust in Postcommunist Europe*, ed. John-Paul Himka and Joanna Beata Michlic (25-58), Nebraska: University of Nebraska Press.
- Rocker, Kailey. 2022. “Translational Justice: Facing the Past to Take on the Present In Albania,” Dissertation Thesis, University of North Carolina - Chapel Hill, 2022, ProQuest.
- Subotić, Jelena. 2019. *Yellow Star, Red Star: Holocaust Remembrance after Communism*. Ithaca: Cornell University Press.
- Verdery, Katherine. 1996. *What was Socialism and What Comes Next?* New Jersey: Princeton University Press.

Rreth autores

Kailey Roker është Profesore Asistente vizitore e antropologjisë kulturore në Universitetin Lawrence në Appleton, Wisconsin, SHBA. Puna e Roker-it si antropologe e kulturës përqëndrohet në Shqipëri me theks në tema të drejtësisë tranzicionale, kujtesës historike, antropologjisë politike dhe trashëgimisë kulturore. Ajo përfundoi doktoraturën në antropologji nga Universiteti i Karolinës së Veriut Chapel Hill në 2022, ku gjithashtu kreu studimet master në antropologji në vitin 2017.

* Ky shkrim u përkthye nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga Rozafa Berisha